



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.24

19 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.67, datë 10.2.2010	Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA)	731
Vendim i KM nr.69, datë 17.2.2010	Për një shtesë në vendimin nr.1070, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë”, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009 – 2010, dhe për një ndryshim në vendimin nr.829, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve, dhe miratimin e kuotave dhe të tarifave për këto programe”.....	732
Vendim i KM nr.81, datë 10.2.2010	Për miratimin e protokollit shtesë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen “Për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve”.....	732
Vendim i KM nr.82, datë 10.2.2010	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen dypalëshe ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë	735
Vendim i KM nr.91, datë 10.2.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.467, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik”	736
Vendim i KM nr.92, datë 10.2.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.1269, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar	739

Vendim i KM nr.93, datë 10.2.2010	Për përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit të ashensorëve.....	740
Vendim i KM nr.94, datë 10.2.2010	Për përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe të sistemeve mbrojtëse, për përdorim në mjedise potencialisht shpërthyesë	742
Vendim i KM nr.96, datë 17.2. 2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, të ndryshuar	747
Vendim i KM nr.100, datë 17.2.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.26, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2010, në ministritë dhe institucionet qendrore”	758
Vendim i KM nr.101, datë 17.2.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar..	759
Vendim i KM nr.102, datë 17.2.2010	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes, që do të tjetërsohet, në favor të subjektit kërkues “City Park” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar	760
Vendim i KM nr.103, datë 17.2.2010	Për një shtesë në vendimin nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë, dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar”.....	760
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Redi Dhama.....	761
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasës Zamira Sinjari	761
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Petraq Kumati	761
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Halil Rustami	762
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lulzim Tabaku	762
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasve Qirjako Adhamidhi dhe Anastas Adhamidhi	762

VENDIM
Nr.67, datë 10.2.2010

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT (IZHA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA), si institucion publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e Institutit të Kurrikulave dhe Trajnimit (IKT).

2. Misioni i IZHA-së është që t’u ofrojë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve arsimore të të gjitha niveleve ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, të mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-shkencore studimore dhe praktikës së arsimit.

3. Instituti i Zhvillimit të Arsimit ka për detyrë:

a) t’u ofrojë ekspertizë strukturale politikëpërbërëse dhe vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit;

b) të zhvillojë punë kërkimore-studimore dhe të ofrojë ekspertizë e këshillim për institucionet arsimore të të gjitha niveleve, në fushat e përmbajtjes kurrikulare, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimit në tërësi;

c) të mbështesë MASH-in në hartimin e studimeve/analizave periodike, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;

ç) të ofrojë këshillim për nxënësit dhe qytetarët në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;

d) të zhvillojë metodologji për sigurimin e cilësisë e vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe programet e tyre mësimore;

dh) të zhvillojë programe dhe standarde për kualifikimin e mësuesve, profesoratit dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore;

e) të zhvillojë metodologji dhe standarde për tekstet mësimore;

ë) të zhvillojë veprimtari informative për institucionet, nxënësit, studentët, punëdhënësit dhe punëmarrësit;

f) të kryejë edhe detyra të tjera, të ngarkuara nga MASH-i dhe qeveria, brenda misionit të tij.

5. Statuti dhe rregullorja e funksionimit të IZHA-së miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Drejtuesi i IZHA-së emërohet, lirohet a shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të IZHA-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

8. Numri i punonjësve të IZHA-së të jetë i përfshirë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

9. Për punonjësit, që, pas riorganizimit, humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

10. IZHA-ja është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

11. Buxheti i planifikuar për Institutin e Kurrikulave dhe Trajnimit, si dhe të gjitha asetet e tij i kalojnë IZHA-së.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

13. Vendimi nr.418, datë 11.7.2007 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Kurrikulave dhe të Trajnimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.69, datë 17.2.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1070, DATË 21.10.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009 – 2010, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.829, DATË 29.7.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË FAKULTETIN E MUZIKËS TË AKADEMISË SË ARTEVE, DHE MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFAVE PËR KËTO PROGRAME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1070, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.81, datë 10.2.2010

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË, PËR NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN “PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit shtesë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen “Për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLL SHITESË

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI NDRYSHIMET E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (këtu quhen “Palët kontraktuese”),

në lidhje me Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve të lidhur në Zagreb, më 10 maj 1993 (këtu quhet “Marrëveshja”),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Neni 1 i Marrëveshjes ndryshohet duke shtuar paragrafët e rinj, 5 dhe 6, pas paragrafit 4, dhe kanë formulimin e mëposhtëm:

“5. Termi “pa vonesë” është një periudhë e tillë që normalisht kërkohet për përfundimin e formaliteteve të nevojshme për transferimin e pagesave.

6. Termi “Monedhë lirisht e konvertueshme” është monedha që Fondi Monetar Ndërkombëtar, herë pas here, i përcakton si monedha lirisht të përdorshme në pajtim me nenet e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe çdo ndryshim të saj.”.

Neni 2

Neni 2 i Marrëveshjes ndryshohet duke shtuar paragrafët e rinj, 4 dhe 5, pas paragrafit 3, që kanë formulimin e mëposhtëm:

“4. Secila palë kontraktuese nuk cenon, nëpërmjet masave të paarsyeshme, arbitrare ose diskriminuese, menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, përfitimin ose disponimin e investimeve në territorin e tij të investitorëve të palës tjetër kontraktuese.

5. Investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të secilës palë kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese u jepet një trajtim i drejtë dhe i barabartë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe gëzon mbrojtje dhe garanci të plotë ligjore.”.

Neni 3

Neni 3 i Marrëveshjes ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Dispozitat e trajtimit kombëtar dhe trajtimit të kombit më të favorizuar

1. Asnjë palë kontraktuese nuk ia nënshtrohet investimet e investitorëve të palës tjetër kontraktuese një trajtimi më pak të favorshëm se ai që u jep investimeve të investitorëve të vet ose investimeve të investitorëve të një shteti të tretë.

2. Asnjë palë kontraktuese nuk ia nënshtrohet investitorët e palës tjetër kontraktuese në lidhje me aktivitetin e tyre për investimet në territorin e tij, një trajtimi më pak të favorshëm se ai që u jep investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë.

3. Dispozitat e trajtimit kombëtar dhe trajtimit të kombit më të favorizuar të këtij neni nuk zbatohen në lidhje me avantazhet e dhëna nga një palë kontraktuese në pajtim me detyrimet e veta si anëtar i një bashkimi doganor, ekonomik ose monetar, një treg të përbashkët ose një zonë e lirë tregtare.

4. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk interpretohen sikur detyrojnë një palë kontraktuese t'u japë investitorëve të palës tjetër kontraktuese përfitimet e një trajtimi, preference ose privilegji që u jepet investitorëve të një shteti të tretë në sajë të detyrimeve të asaj pale kontraktuese si anëtar i një bashkimi doganor, ekonomik ose monetar, një tregu të përbashkët ose një zone të lirë tregtare, që rrjedhin nga një marrëveshje ndërkombëtare ose masë reciprociteti i atij bashkimi doganor, ekonomik, monetar, tregu të përbashkët ose zone të lirë ekonomike.

5. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk interpretohen sikur detyrojnë një palë kontraktuese t'u japë investitorëve të palës tjetër kontraktuese ose investimeve apo të ardhurave të këtyre investitorëve përfitimin e një trajtimi, preference ose privilegji që mund të jepet nga një palë kontraktuese në sajë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose mase në lidhje të plotë ose të pjesshme me tatimin.”.

Neni 4

Neni 6 i Marrëveshjes ndryshohet duke shtuar paragrafin e ri 3 pas paragrafit 2, me formulimin e mëposhtëm:

“3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen pa cenuar masat e miratuara nga Komuniteti European.”.

Neni 5

Pas nenit 7 të Marrëveshjes shtohet neni i ri 8, me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 8

Mjetet thelbësore të sigurisë

Kjo Marrëveshje nuk përjashton zbatimin nga secila palë kontraktuese të masave të nevojshme për ruajtjen e rendit publik, përmbushjen e detyrimeve në lidhje me ruajtjen ose rivendosjen e paqes ose sigurisë ndërkombëtare, ose mbrojtjen e interesave të veta thelbësore, të sigurisë që mund të përfshijnë interesa që rrjedhin nga anëtarësia në një bashkim doganor, ekonomik ose monetar, treg të përbashkët ose zonë të lirë ekonomike.”.

Neni 6

Nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të Marrëveshjes bëhen nenet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Neni 7

Protokolli shtesë përbën një pjesë përbërëse të Marrëveshjes.

Protokolli shtesë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi.

Bërë në Zagreb, më 10 shkurt 2009, në dy kopje origjinale, secila në kroatisht, shqip dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëllloj autentike. Në rastin e një mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

VENDIM
Nr.82, datë 10.2.2010

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË, PËR NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN DYPALËSHE EKONOMIKE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen dypalëshe ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN MBI MARRËDHËNIET EKONOMIKE DYPALËSHE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (këtu quhen “Palët kontraktuese”),

në lidhje me marrëveshjen mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, të përfunduar në Zagreb, më 10 maj 1993 (këtu të quajtur “Marrëveshja”),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Neni 2 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 2

Neni 8 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 10 të Marrëveshjes, paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 4

Pas nenit 10 të Marrëveshjes, shtohet neni i ri “10 a”, që lexon si më poshtë:

“Neni 10 a

Që nga data e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, kjo Marrëveshje zbatohet pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga kjo anëtarësi. Për pasojë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen ose interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë mbi detyrimet e vendosura nga Traktati i Bashkimit Europian dhe Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar në Luksemburg më 12 qershor 2006.

Për më tepër, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen apo interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë në detyrimet që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare që do të lidhen, duke zëvendësuar marrëveshjet e mësipërme.”.

Neni 5

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë mbi ndryshimet e Marrëveshjes mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë hyn në fuqi në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, në të cilën Republika e Kroacisë, në kohën e duhur, do të informojë Republikën e Shqipërisë, me kusht që në atë datë palët kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Nëse palët kontraktuese nuk njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë mbi ndryshimet e Marrëveshjes mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Bërë në Zagreb, më 10 shkurt 2009, në dy kopje origjinale, secila në shqip, kroatisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht mbizotëron.

VENDIM

Nr.91, datë 10.2.2010

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.467, DATË 18.7.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN, SHKENCOR E PEDAGOGJIK, TË PERSONELIT
AKADEMIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.467, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I “Dispozita të përgjithshme” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.3 Universitetet, që kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik për titullin “Profesor”, janë:

- a) Universiteti i Tiranës;
- b) Universiteti Politeknik i Tiranës;
- c) Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- ç) Akademia e Arteve të Bukura, Tiranë;
- d) Akademia e Kulturës Fizike dhe Sporteve, Tiranë;
- dh) Qendrat kërkimore-shkencore, me status të krahasueshëm me atë të një universiteti.

1.3.1 Institucionet e arsimit të lartë (më tej universitetet), që kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik për titujt “Profesor i Asociuar”, janë institucionet e arsimit të lartë publik.”.

- b) Pika 1.5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.5 Për organizimin dhe drejtimin e kualifikimit, shkencor e pedagogjik, pas doktoratës, në fakultetet e institucioneve të arsimit të lartë ngrihet këshilli i profesorëve (KP). Në të bëjnë pjesë të gjithë profesorët me kohë të plotë të fakultetit. Numri minimal i anëtarëve të KP-së është shtatë veta, nga të cilët, së paku, pesë janë “Profesorë”. Një ose dy anëtarë të KP-së janë “Prof. Asoc.”, të punësuar me kohë të plotë, në fakultetin në fjalë ose fakultete të tjera të universitetit, që janë në prag të promovimit për titullin “Profesor”. Në rast se numri i profesorëve të fakultetit është më i vogël se pesë, për të arritur këtë numër në KP mund të thirren deri dy profesorë, të ftuar nga fakultetet e tjera, brenda universitetit ose nga universitete e tjera brenda ose jashtë vendit.

Një profesor e drejton KP-në, me rotacion, për një vit akademik. Përbërja dhe funksionimi i KP-së rregullohen në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë.”.

2. Në kreun II “Kriteret dhe procedurat për dhënien e titujve akademikë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Paragrafi i dytë i shkronjës “c” të pikës 2.1.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë) që ka realizuar, së paku, tri koncerte recitale–premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), ndër të cilat, së paku, 1 (një) të jetë realizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku vepra të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.”.

- b) Paragrafi i dytë i shkronjës “ç” të pikës 2.1.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si solist, së paku, në 2 (dy) realizime artistike (koncerte premierë, vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, ndër të cilat, së paku, 1(një) të luajtur nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.”.

- c) Paragrafi i dytë i shkronjës “b” të pikës 2.2.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka realizuar së paku 4 (katër) koncerte recitale-premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), ndër të cilat, së paku, 1(një) të realizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.”.

ç) Paragrafi i dytë i shkronjës “c” të pikës 2.2.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si i parë, së paku, në 4 (katër) realizime artistike (solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara, ndër të cilat, së paku, 1(një) të luajtur nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.”.

d) Shkronja “ç” e pikës 2.1.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Diploma “Docent” nënshkruhet nga dekani dhe rektori, dhe vuloet me vulë të thatë, pasi është regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucionin e arsimit të lartë.”.

dh) Paragrafi i parë i pikës 2.2.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Promovimi për titullin “Prof. Asoc.” bëhet nga KP-të e fakulteteve të institucioneve të arsimit të lartë publik (më tej universitetet), me kërkesë të vetë kandidatit/es. Kandidatët, që punojnë me kohë të plotë, pranë institucioneve të arsimit të lartë, dorëzojnë dosjen te dekani i fakultetit të tyre. Dekani ia kalon dosjen KP-së së fakultetit, i cili brenda një muaji jep mendim për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatit/es. Në rastet kur një fakultet nuk ka arritur të krijojë KP-në, dekani i kërkon rektorit të universitetit ta përcjellë dosjen në një nga IAL-të e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.”.

e) Paragrafi i fundit i pikës 2.2.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Diploma “Prof. Asoc.” nënshkruhet nga dekani e rektori, vuloet me vulë të thatë, pasi është regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të universitetit.”.

10. Paragrafi i dytë i shkronjës “d” të pikës 2.3.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka realizuar pas marrjes së titullit “Prof.Asoc.”, së paku, 6 (gjashtë) koncerte recitale-premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), ndër të cilat, së paku, 2 (dy) të realizuara jashtë Republikës së Shqipërisë në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku performanca (vepra) të jetë pranuar, në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse, në shtypin profesional.”.

ë) Paragrafi i dytë i shkronjës “dh” të pikës 2.3.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si i parë, së paku, në 7 (shtatë) realizime artistike (solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara, ndër të cilat, së paku, 3 (tri) të luajtura nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse, në shtypin profesional.”.

f) Shkronja “c” e pikës 2.3.2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“c) Brenda një muaji, senati e shqyrton kërkesën dhe merr vendim për t’i propozuar Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë komisionin vlerësues. Titullari i institucionit i dërgon kryetarit të KVTA-së, vendimin e senatit.”.

g) Në fund të shkronjës “ç” të pikës 2.3.2 shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

“Vendimi i KVTA-së për përbërjen e komisionit vlerësues dhe fillimin e vlerësimit pedagogjik të kandidatit i dërgohet për zbatim titullarit të institucionit.”.

gj) Shkronja “dh” e pikës 2.3.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Komisioni vlerësues harton një raport përfundimtar vlerësues për veprimtarinë botuese dhe aftësitë pedagogjike të kandidatit/es, së bashku me rekomandimin për dhënien ose jo të titullit. Raporti i dërgohet titullarit të institucionit, i cili ia përcjell atë, së bashku me dosjen përkatëse, kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë.”.

h) Pika 2.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.4 Titujt “Akademik i Asociuar” dhe “Akademik” janë tituj, që fiton çdo profesor, i cili është pranuar anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Në rastin kur ai/ajo është profesor në institucionin e arsimit të lartë, gëzon të gjitha atributet, që i takojnë titullit “Akademik i Asociuar” dhe “Akademik”.”.

j) Pas pikës 2.6 shtohet pika 2.7, me këtë përmbajtje:

“2.7. Të gjitha shpenzimet, që lidhen me promovimin për titujt akademikë, përballohen nga të ardhurat e institucionit të arsimit të lartë, ku zhvillohet procedura.”.

3. Pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, të kreut III, “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, shfuqizohen.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e arsimit të lartë publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.92, datë 10.2.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1269, DATË 17.9.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHETËTËRORE, TË NGARKUARA PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e shkronjës “A” të kreut I “Përbërja, mënyra e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar të Tokës (KQT)”, e vendimit nr.1269, datë 17.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Komisioni Qeveritar i Tokës kryesohet nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe përbëhet nga:

- Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëvendëskryetar;
- Ministri i Brendshëm, anëtar;
- Ministri i Drejtësisë, anëtar;
- Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, anëtar.

Kur për shkaqe të arsyeshme, ministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit Qeveritar të Tokës, atëherë ai duhet të kërkojë paraprakisht, me shkrim, duke paraqitur këto shkaqe, miratimin e Kryetarit. Në vend të tij, me miratimin me shkrim të Kryetarit, merr pjesë, me të drejtë vote, zëvendësministri i autorizuar nga ministri.

Në mbledhjen e Komisionit Qeveritar të Tokës merr pjesë rregullisht, pa të drejtë vote:
- Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë,
- Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit të Burimeve dhe Ofrimit të Shërbimeve në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.93, datë 10.2.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE,
QË KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË
ASHENSORËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, pika 19, e 27 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit të ashensorëve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të ashensorëve me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në vendimin nr.91, datë 27.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të ashensorëve””.
3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE QË KANË KARAKTER
REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË ASHENSORËVE, SIPAS VENDIMIT
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.91, DATË 27.1.2009**

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar	Viti i adoptimit si standard shqiptar S SH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë, Fp. ose me përkthim të plotë, Pp)
1	S SH EN 81-1: 1998 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Pjesa 1: Ashensorët elektrikë	1999	Fp
	S SH EN 81-1: 1998/A1:2005	2009	
	S SH EN 81-1: 1998/AC:1999	2007	
2	S SH EN 81-2: 1998 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Pjesa 2: Ashensorët hidraulikë	1999	Fp
	S SH EN 81-2: 1998/A1:2005	2009	
	S SH EN 81-2: 1998/AC:1999	2007	
3	S SH EN 81-28: 2003 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Ashensorë për transportin e njerëzve dhe të mallrave – Pjesa 28: Alarm që vepron në largësi për ashensorët për transportimin e njerëzve dhe të mallrave	2006	Fp
4	S SH EN 81-58: 2003 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Ekzaminimi dhe provat – Pjesa 58: Prova e zjarrqëndrueshmërisë së dyerve të zbritjes në kate	2006	Fp
5	S SH EN 81-70: 2003 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Zbatime të veçanta në ashensorët e udhëtarëve dhe për mallrat e tyre – Pjesa 70: Mundësia e hyrjes në ashensorë për persona, përfshirë persona me aftësi të kufizuar/invalidë	2006	Fp
	S SH EN 81-70: 2003/A1:2004	2007	
6	S SH EN 81-71: 2005 + A1:2006 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Zbatime të veçanta në ashensorët e udhëtarëve dhe për mallrat e tyre – Pjesa 71: Ashensorë rezistent ndaj shkatërrimit	2009	Fp
7	S SH EN 81-72: 2003 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Zbatime të veçanta në ashensorët e udhëtarëve dhe për mallrat e tyre – Pjesa 72: Ashensorët e zjarrfikësave	2006	Fp
8	S SH EN 81-73: 2005 Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Zbatime të veçanta në ashensorët e udhëtarëve dhe për mallrat e tyre – Pjesa 73: Sjellja e ashensorëve në rastin e zjarrit	2007	Fp
9	S SH EN 12016:2004 + A1:2008 Kompatibiliteti elektromagnetik–Standarde të familjes së produkteve për ashensorët. Shkallët mekanike dhe konvejerët për pasagjerët – Rezistenca	2009	Fp
10	S SH EN 12385-3:2004 + A1:2008 Kavo çeliku-Siguria-Pjesa3:Informacion për përdorimin dhe mirëmbajtjen	2009	Fp
11	S SH EN 12385-5:2002 Kablllo çeliku-Siguria-Pjesa 5:Kablllo me damarë për ashensorët	2006	Fp
	S SH EN 12385-5:2002/AC:2005	2008	
12	S SH EN 13015:2001 + A1:2008 Mirëmbajtja e ashensorëve dhe e shkallëve mekanike – Rregullat për instruksionet e mirëmbajtjes	2009	Fp
13	S SH EN 13411-7:2006 + A1:2008 Fundet për kavot me fije çeliku – Siguria – Pjesa 7: Xhunto konike simetrike	2009	Fp

VENDIM
Nr.94, datë 10.2.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE,
QË KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË
PAJISJEVE DHE TË SISTEMEVE MBROJTËSE, PËR PËRDORIM NË MJEDISE
POTENCIALISHT SHPËRTHYESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, pika 19, e 27 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, për përdorim në mjedise potencialisht shpërthyes, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse për përdorim në mjedise potencialisht shpërthyes, me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në vendimin nr.142, datë 11.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse për përdorim në mjedise potencialisht shpërthyes””.

3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE QË KANË KARAKTER
REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE DHE SISTEMEVE
MBROJTËSE QË PËRDOREN NË ATMOSFERA POTENCIALISHT SHPËRTHYESE, SIPAS
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.142, DATË 11.2.2009**

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit në shqip	Viti i adoptimit si standard shqiptar S SH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë, Fp. ose me përkthim të plotë, Pp)
1	S SH EN 1010-1:2004 Siguri e makinerisë – Kërkesa sigurie për projektimin dhe ndërtimin e makinave të printimit dhe të kthimit të letërës – Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme	2007	Fp
2	S SH EN 1010-2:2006 Siguri e makinerisë – Kërkesa sigurie për projektimin dhe ndërtimin e makinave të printimit dhe të kthimit të letërës – Pjesa 2: Makina printimi dhe llakimi, duke përfshirë dhe makineri para shtypi	2007	Fp
3	S SH EN 1127-1:2007 Atmosfera shpërthyesë – Parandalimi dhe mbrojtja nga shpërthimi – Pjesa 1: Konceptet bazë dhe metodologjia	2009	Fp
4	S SH EN 1127-2:2002+A1:2008 Atmosfera shpërthyesë – Parandalimi dhe mbrojtja nga shpërthimi – Pjesa 2: Konceptet bazë dhe metodologjia për shfrytëzimin e minierave	2009	Fp

5	S SH EN 1710:2005+A1:2008 Pajisje dhe komponentë të destinuar për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes në minierat nën tokë	2008	Fp
6	S SH EN 1755:2000 Siguri e rimorkiove industriale – Përdorimi në atmosfera potencialisht shpërthyes – Përdorimi në atmosfera me gaz të djegshëm, me avuj, mjegull dhe pluhura të ndezshëm	2002	Fp
7	S SH EN 1834-1:2000 Motorë alternativë me djegie të brendshme – Kërkesa sigurie për projektimin dhe konstruksionin e motorëve që përdoren në atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa 1: Motorët e grupit II për përdorim në atmosfera me gaz dhe avuj të ndezshëm	2006	Fp
8	S SH EN 1834-2:2000 Motorë alternativë me djegie të brendshme – Kërkesa sigurie për projektimin dhe konstruksionin e motorëve që përdoren në atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa 2: Motorët e grupit që përdoren në punime nëntokësore të ndjeshme ndaj gazit të minierave dhe/ose përzierjeve plasëse	2002	Fp
9	S SH EN 1834-3:2000 Motorë alternativë me djegie të brendshme – Kërkesa sigurie për projektimin dhe konstruksionin e motorëve që përdoren në atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa 3: Motorët e grupit II për përdorim në atmosfera me pluhur të ndezshëm	2006	Fp
10	S SH EN 1839:2003 Përcaktimi i kufijve të shpërthimit të gazeve dhe avujve	2004	Fp
11	S SH EN 12581:2005 Implante veshjeje – Makineri për veshje në zhytje dhe elektrodepozitë prej material veshje të lëngut organik – Kërkesa të sigurisë	2007	Fp
12	S SH EN 12621:2006 Makineri për materiale veshje për pajisje dhe qarkullim nën presion – Kërkesa të sigurisë	2007	Fp
13	S SH EN 12757-1:2005 Makineri përzierëse për materialet veshëse – kërkesa sigurie – Pjesa 1: Makineri përzierëse për përdorim në automjetet që rilustohen	2007	Fp
14	S SH EN 12874:2001 Ndalues të flakës – Kërkesat për performancën, metodat e provave dhe kufijtë për përdorim	2004	Fp
15	S SH EN 13012:2001 Stacione mbushëse të naftës – ndërtimi dhe cilësitë e injektorëve automatikë që përdoren në distributorët e karburantit	2002	Fp
16	S SH EN 13160-1:2003 Sisteme të gjurmimit e të pikimit – Pjesa 1: Parime të përgjithshme	2004	Fp
17	S SH EN 13237:2003 Atmosfera potencialisht shpërthyes – Termat dhe përkufizimet për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që përdoren në atmosfera potencialisht shpërthyes	2005	Fp
18	S SH EN 13463-1:2001 Pajisje joelektrike për atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa 1: Kërkesat dhe metoda bazë	2004	Fp
19	S SH EN 13463-2:2004 Pajisje joelektrike për atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa 2: Mbrojtja prej mbylljes me qarkullim të kufizuar “fr”	2008	Fp
20	S SH EN 13463-3:2005 Pajisje joelektrike për atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa 3: Mbrojtja prej mbylljes kundër zjarrit “d”	2008	Fp
21	S SH EN 13463-5:2003 Pajisje joelektrike për atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa 5: Mbrojtja sipas sigurisë së konstruksionit “c”	2004	Fp
22	S SH EN 13463-6:2005 Pajisje joelektrike për atmosfera potencialisht shpërthyes – Pjesa	2008	Fp

	6: Mbrojtja prej kontrollit të burimit të ndezjes “b”		
23	S SH EN 13463-8:2003 Pajisje joelektrike për atmosfera potencialisht shpërthyesë – Pjesa 8: Mbrojtja me anë të zhytjes në lëng “k”	2004	Fp
24	S SH EN 13616:2004 Pajisje të parandalimit të mbimbushjes për rezervuarët statikë për lëndë djegëse të lëngshme S SH EN 13616:2004/AC:2006	2007	Fp
25	S SH EN 13617-1:2004 Stacione të shpërndarjes së karburanteve – Pjesa 1: Kërkesat e sigurisë për ndërtimin dhe funksionimin e pompave matëse, shpërndarësve dhe pajisjeve të pompimit në distancë S SH EN 13617-1:2004/AC:2006	2005	Fp
26	S SH EN 13617-2:2004 Stacione të mbushjes së benzinës – Pjesa 2: Kërkesat e sigurimit teknik për ndërtimin dhe efektshmërinë e kasave të sigurisë që përdoren në pompat e matjes dhe distributorëve	2006	Fp
27	S SH EN 13617-3:2004 Stacione të mbushjes së benzinës – Pjesa 3: Kërkesat e sigurimit teknik për ndërtimin dhe efektshmërinë e pistoletave të karburantit	2006	Fp
28	S SH EN 13673-1:2003 Përcaktimi i presionit maksimal të shpërthimit dhe madhësia maksimale e ngritjes së presionit të gazeve dhe të avujve – Pjesa 1: Përcaktimi i presionit maksimal të shpërthimit	2004	Fp
29	S SH EN 13673-2:2005 Përcaktimi i presionit maksimal të shpërthimit dhe shpejtësisë maksimale të ngritjes së presionit të gazeve dhe avujve – Pjesa 2: Përcaktimi i shpejtësisë maksimale të ngritjes së presionit shpërthyes	2008	Fp
30	S SH EN 13760:2003 Sistemi i mbushjes me GLN (Gaz i lëngët nga nafta) për automjete të mjeteve të transportit me ngarkesa të lehta dhe të rënda – Duza, kërkesat e provës dhe dimensionet	2006	Fp
31	S SH EN 13821:2002 Atmosfera potencialisht shpërthyesë – Parandalimi dhe mbrojtja nga shpërthimi – Përcaktimi i energjisë minimale të ndezjes së përzierjeve pluhur/ajër	2004	Fp
32	S SH EN 13980:2002 Atmosfera potencialisht shpërthyesë – Zbatimi i sistemeve të cilësisë	2006	Fp
33	S SH EN 14034-1:2004 Përcaktim i karakteristikave të shpërthimit të reve të pluhurit – Pjesa 1: Përcaktimi i presionit maksimal të shpërthimit p _{max} të reve të pluhurit	2008	Fp
34	S SH EN 14034-2:2006 Përcaktimi i karakteristikave shpërthyesë të reve të pluhurit – Pjesa 2: Përcaktimi i shpejtësisë maksimale të ngritjes së presionit shpërthyes (dp/dt) max i reve	2008	Fp
35	S SH EN 14034-3:2006 Përcaktim i karakteristikave shpërthyesë të reve të pluhurit – Pjesa 3: Përcaktimi i kufirit më të ulët të shpërthimit LEL të reve të pluhurit	2008	Fp
36	S SH EN 14034-4:2004 Përcaktim i karakteristikave të shpërthimit të reve të pluhurit – Pjesa 4: Përcaktimi i kufijve të përqendrimit të oksigjenit LOC të reve të pluhurit	2008	Fp
37	S SH EN 14373:2005 Sisteme të eliminimit të shpërthimit	2008	Fp
38	S SH EN 14460:2006 Pajisje rezistente ndaj shpërthimit	2008	Fp
39	S SH EN 14491:2006 Sistemet mbrojtëse në rastet e shpërthimeve të pluhurit	2008	Fp

	S SH EN 14491:2006/AC:2008	2009	
40	S SH EN 14492-1:2006 Vinça-Arganot dhe ngritësit mekanikë-Pjesa1: Arganot mekanikë	2007	Fp
41	S SH EN 14492-2:2006 Vinça-Arganot dhe ngritësit mekanikë-Pjesa2:Ngritësit mekanikë	2007	Fp
42	S SH EN 14522:2005 Përcaktim i temperaturës së vetëndezjes së gazrave dhe avujve	2008	Fp
43	S SH EN 14591-1:2004 Parandalim dhe mbrojtje kundër shpërthimit në minierat nën tokë-Sisteme mbrojtëse-Pjesa 1: Mbyllës ajri me rezistencë shpërthimi 2-bar	2008	Fp
	S SH EN 14591-1:2004/AC:2006		
44	S SH EN 14591-2:2007 Mbrojtje kundër shpërthimit në minierat nën tokë - Sistemet mbrojtëse-Pjesa 2: Pengesat e rezervuarëve të ujit pasiv	2008	Fp
45	S SH EN 14591-4:2007 Mbrojtje kundër shpërthimit në minierat nëntokësore - Sistemet mbrojtëse-Pjesa 4: Instalimi i makinave me shpërthim për fikjen automatike të menjëhershme	2008	Fp
	S SH EN 14591-4:2007/AC:2008	2009	
46	S SH EN 14677:2008 Siguri e makinerisë-Prodhi i çelikut dytësor-Makineri dhe pajisje për përpunimin e çelikut likuid	2009	Fp
47	S SH EN 14678-1:2006 Pajisje dhe pjesë këmbimi të GLN-Konstruksioni dhe performanca e pajisjeve të GLN për stacionet e furnizimit të automjeteve-Pjesa 1:Shpërndarësit automatik me monedhë (xheton)	2006	Fp
48	S SH EN 14681:2006 Siguri e makinerisë-Kërkesa të sigurisë për makineri dhe pajisje për prodhimin e çelikut në furrat me hark elektrik	2007	Fp
49	S SH EN 14756:2006 Përcaktim i kufirit të përqendrimit të oksigjenit (LOC) për gazrat dhe avujt e djegshëm	2008	Fp
50	S SH EN 14797:2006 Dispozita të shkarkimit të shpërthimit	2008	Fp
51	S SH EN 14973:2006 Shirita konvejeri për përdorim në instalimet nëntokësore-Kërkesat e sigurisë elektrike dhe aftësisë ndezëse	2007	Fp
	S SH EN 14973:2006/AC:2007	2009	
52	S SH EN 14983:2007 Parandalim dhe mbrojtje nga shpërthimi në minierat nën tokë-Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për kapjen e gazeve shpërthyesë të minierave	2008	Fp
53	S SH EN 14986:2007 Projektimi i ventilatorëve në atmosfera shpërthyesë potenciale	2008	Fp
54	S SH EN 14994:2007 Sisteme mbrojtëse për rastet kundër shpërthimit të gazit	2008	Fp
55	S SH EN 15188:2007 Përcaktim i sjelljes spontane të ndezjes së grumbullimeve të pluhurit	2008	Fp
56	S SH EN 15198:2007 Metodologji e vlerësimit të rrezikut të pajisjeve joelektrike dhe përbërësve të destinuar për t'u përdorur në atmosfera shpërthyesë	2008	Fp
57	S SH EN 15233:2007 Metodologji për vlerësimin e sigurisë funksionale të sistemeve mbrojtëse për atmosfera shpërthyesë potenciale	2008	Fp
58	S SH EN 15268:2008 Stacione të shpërndarjes së karburanteve-Pjesa 1: Kërkesat e sigurisë për ndërtimin dhe montimin e pompave të zhytura në ujë	2009	Fp
59	S SH EN 50050:2006 Aparate elektrike për atmosfera potencialisht shpërthyesë-Pajisja spërkatëse elektrostatike që mbahet në dorë	2008	Fp

60	S SH EN 50104:2002 Aparate elektrike për zbulimin dhe matjen e oksigjenit- Kërkesat për performancën dhe metodat e provave S SH EN 50104:2002/A1:2004	2007	Fp
61	S SH EN 50241-1:1999 Specifikime për aparatet me rrugë të hapur për zbulimin e gazrave dhe të avujve të djegshëm ose helmues-Pjesa 1:Kërkresa të përgjithshme dhe metodat e provave S SH EN 50241-1:1999/A1:2004	2008	Fp
62	S SH EN 50241-2:1999 Specifikime për aparatet me rrugë të hapur për zbulimin e gazrave dhe të avujve të djegshëm ose helmues-Pjesa 2:Kërkresat e performancës për aparatet për zbulimin e gazrave të djegshëm	2008	Fp
63	S SH EN 50281-2-1:1998 Aparat elektrik për përdorim në prani të pluhurit të djegshëm-Pjesa 2-1:Metodat e provës-metodat e përcaktimit të temperaturave minimale të ndezjes	2005	Fp
64	S SH EN 50303:2000 Pajisje të grupit I të kategorisë M1 të destinuara për të funksionuar në atmosfera të rrezikuara nga gazi i minierës dhe/ose nga pluhuri i qymyrit	2005	Fp
65	S SH EN 50381:2004 Dhoma të ventiluara të transportueshme me ose pa një burim të brendshëm çlirimi S SH EN 50381:2004/AC:2005	2008 2009	Fp
66	S SH EN 60079-0:2006 Aparate elektrike për atmosfera gazshpërthyes-Pjesa 0: Kërkesa të përgjithshme	2008	Fp
67	S SH EN 60079-1:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 1: Mbrojtja e pajisjes nëpërmjet veshjeve të padepërtueshme nga zjarri “d”	2008	Fp
68	S SH EN 60079-2:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 2: Mbrojtja e pajisjes nëpërmjet veshjes së presuar “p”	2008	
69	S SH EN 60079-5:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 5: Mbrojtja e pajisjes nëpërmjet mbushjes me pluhur “q”	2008	Fp
70	S SH EN 60079-6:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 6: Mbrojtja e pajisjes nëpërmjet zhytjes në vaj “0”	2008	Fp
71	S SH EN 60079-7:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 7: Mbrojtja e pajisjeve nëpërmjet sigurisë së rritur “e”	2008	Fp
72	S SH EN 60079-11:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 11: Mbrojtja e pajisjes nga siguria e brendshme “i”	2008	Fp
73	S SH EN 60079-15:2005 Aparate elektrike për atmosfera gazshpërthyes-Pjesa 15: Ndërtimi, prova dhe markimi i tipit të aparaturave mbrojtëse “n”	2008	Fp
74	S SH EN 60079-18:2004 Aparate elektrike për atmosfera gazshpërthyes-Pjesa 18: Ndërtimi, prova dhe markimi i tipit të aparatit mbrojtës elektrik “m” me kapsulim S SH EN 60079-18:2004/AC:2006	2005 2009	Fp
75	S SH EN 60079-25:2004 Aparate elektrike për atmosfera gazshpërthyes-Pjesa 25: Sistemet e veçanta të sigurisë	2005	Fp
76	S SH EN 60079-26:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 26: Aparate me nivel të pajisjes mbrojtëse (EPL) Ga	2008	Fp

77	S SH EN 60079-27:2008 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 27: Koncepti i sigurisë së brendshme të rrjetit tokësor (FISCO)	2008	Fp
78	S SH EN 60079-28:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 28: Mbrojtja e pajisjeve dhe sistemeve të transmetimit që përdorin rrezatim optik	2008	Fp
79	S SH EN 60079-29-1:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 29-1: Detektorët e gazit-Kërkesat e performancës së detektorëve për gazet e djegshme	2008	Fp
80	S SH EN 60079-30-1:2007 Atmosfera shpërthyes-Pjesa 30-1: Ngrohja e linjave nëpërmjet rezistencave elektrike-Kërkesat e përgjithshme dhe të provës	2008	Fp
81	S SH EN 61241-0:2006 Aparatura elektrike për përdorim në prani të pluhurit të djegshëm-Pjesa 0:Kërkesa të përgjithshme	2008	Fp
82	S SH EN 61241-1:2004 Aparate elektrike për përdorim në prani të pluhurit të djegshëm-Pjesa 1:Mbrojtja nëpërmjet veshjes "tD"	2008	Fp
83	S SH EN 61241-4:2006 Aparatura elektrike për përdorim në prani të pluhurit të djegshëm-Pjesa 4:Tipi i Mbrojtjes "pD"	2008	Fp
84	S SH EN 61241-11:2006 Aparate elektrike për përdorim në prani të pluhurit të djegshëm-Pjesa 11:Mbrojtja nëpërmjet sigurisë së brendshme "iD"	2008	Fp
85	S SH EN 61241-18:2004 Aparate elektrike për përdorim në prani të pluhurit të djegshëm-Pjesa 18:Mbrojtja me kapsulim "mD"	2008	Fp
86	S SH EN 62013-1:2006 Llamba kapuç për përdorime në miniera, të ndjeshme ndaj gazit shpërthyes-Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme-Ndërtimi dhe prova në lidhje me rrezikun e shpërthimit	2008	Fp

VENDIM
Nr.96, datë 17.2.2010

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.781, DATË 14.11.2007 "PËR KARAKTERISTIKAT TEKNIKE E FUNKSIONALE TË PAJISJEVE FISKALE, SISTEMIT TË INTEGRUAR TË KOMPJUTERIZUAR PËR TRANSFERIMET PERIODIKE, AUTOMATIKE, TË DEKLARIMEVE FINANCIARE, SISTEMIT TË KOMUNIKIMIT, PËR PROCEDURËN E DOKUMENTACIONIN PËR MIRATIMIN E TYRE DHE PËR KRITERET PËR PAJISJEN, ME AUTORIZIM, TË SHOQËRIVE TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E PAJISJEVE FISKALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 nenit 55 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.781 datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kreu I "Dispozita të përgjithshme" ndryshon si më poshtë vijon:

"I. Dispozita të përgjithshme

1. Detyrimi për instalimin e pajisjeve fiskale

Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, ose në sektorët e veçantë të përcaktuar në këtë endim apo në udhëzimet e

Ministrisë së Financave, janë të detyruar të përdorin pajisje apo sisteme fiskale, për regjistrimin e qarkullimit, duke lëshuar kuponin tatimor.

2. Pajisja fiskale dhe sistemi fiskal

2.1 Pajisja fiskale është një regjistruer elektronik fiskal ose një printer fiskal (i cili është analog i regjistruerit elektronik fiskal) që përdoren si pajisje më vete apo e përfshirë në pikën e shitjes.

Pajisja fiskale përbëhet nga:

- a) memorie operative RAM;
- b) memoria fiskale;
- c) qarku i shiritit kontrollit elektronik (QSHKE);
- ç) program i logjikës së pajisjes fiskale (Firmware);
- d) transmetuesi i të dhënave, pjesë përbërëse ose e bashkëngjitur;
- dh) printuesi i kuponit.

Pajisjet fiskale bëjnë regjistrimin e të dhënave për vlerën e mallrave të shitura dhe të shërbimeve të kryera për klientët, në shiritin e kontrollit elektronik dhe në memorien fiskale, duke siguruar në këtë mënyrë gjenerimin e raporteve të veçanta;

2.2 Sistemi fiskal për sektorë të veçantë ka kërkesa të veçanta, të cilat miratohen në përputhje me legjislacionin.

3. Sistemi i integruar kompjuterik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Sistemi i integruar kompjuterik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për transferimin periodik, automatik, të deklarimeve financiare dhe përpunimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave nga ekspertët tatimorë, është një sistem, që përmbledh të gjitha transferimet periodike të raporteve tatimore ditore të pajisjeve fiskale.

4. Sistemi i komunikimit për transmetimin e të dhënave

Sistemi i komunikimit ndërmjet tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, realizohet nëpërmjet një rrjeti të sigurt transmetimi të dhënash të nënshkruara në mënyrë elektronike.

Tatimpaguesit duhet të realizojnë kalimin e raporteve tatimore të pajisjes fiskale në mënyrë periodike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet sistemit të sigurt të transmetimit të të dhënave GPRS.

Transmetimi i të dhënave të xhiros në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve bëhet pas mbylljes së raportit tatimor ditë në mënyrë automatike. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përshtat infrastrukturën në bazë të marrëveshjes që bëjnë shoqëritë e autorizuar me operatorin e telefonisë celulare për sigurimin e shërbimit sipas kësaj skeme.

5. Karakteristikat e pajisjes fiskale

Pajisja fiskale, nëpërmjet së cilës memorizohet qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve, duhet të ketë këto karakteristika:

- Programin e logjikës (Firmware), i cili është i mbrojtur nga ndryshimi dhe fshirja, duke përdorur funksionet standarde për regjistrimin e shifrave të mallrave e shërbimeve, printimin, shfaqjen në ekran dhe administrimin e të dhënave, të hyra në një memorie fiskale.

- Letrën shirit (më poshtë e referuar si kupon tatimor) që gjenerohet nga pajisja fiskale, e cila duhet të ketë të printuar logon fiskale, të përbërë prej stemës së Republikës së Shqipërisë, simboleve “RSH” (Republika e Shqipërisë) e “MF” (Ministria e Financave) dhe numrin e identifikimit të pajisjes fiskale, të cilat nënkuptojnë mbajtjen e regjistrimeve të xhiros, nëpërmjet pajisjes fiskale të autorizuar, sipas numrit të identifikimit në Republikën e Shqipërisë.

- Siguron leximin e xhiros së regjistruar, sipas ditës, muajit dhe vitit.

- Siguron leximin e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale dhe QSHKE.

- Siguron ruajtjen e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale dhe regjistrimin e tyre në QSHKE.

- Siguron regjistrimin e xhiros mbi një kupon tatimor, që i jepet klientit.

- Siguron regjistrimin e vlerës reale të mallrave dhe/ose shërbimeve, nëpërmjet rrumbullakimit deri në dy shifra pas presjes dhjetore.

- Siguron kushte për kryerjen e provës, për arsye të kontrollit të saktësisë së pajisjes dhe memories fiskale, si dhe të funksionit në lidhje me të.

- Mundëson rifillimin e veprimeve, nga çasti i ndërprerjes, pas eliminimit të defekteve, me përjashtim të rasteve kur ka probleme të prishjes së memories fiskale.

- Ka memorie operacionale (RAM), ku jepen emërtimet e mallrave apo shërbimeve që janë futur, çmimi, mënyra e pagesës, paraqitja e hollësishme e shkallëve tatimore, të shënuar me shkronjat “A-I”, përqindja e taksës së zbatuar si dhe mundësinë për printimin e automatizuar të emërtimit të mallrave me çmimet dhe shkallët tatimore përkatëse, të futura më parë në memorien operacionale;

- Siguron mbylljen me një pikë të dukshme, me vulën fiskale, duke mos lejuar hapjen.

- Siguron mbrojtje fizike të informacionit të ruajtur në memorien fiskale.

- Siguron bllokimin e pajisjes fiskale, duke shfaqur mesazhin “Gabim” në qoftë se një nga pjesët e tij funksionale është jashtë përdorimit, mungon apo nuk përmbush kushtet për kërkesat, teknike dhe funksionale.

- Siguron futjen e të dhënave në memorien fiskale. Të dhënat nuk mund të jenë më të vjetra se data e regjistrimit të të dhënave paraprake në memorien fiskale, ndërsa të dhënat më të reja nuk mund të jenë më të vjetra se data për të cilën është përgatitur raporti tatimor ditor.

- Ndalon fshirjen e të dhënave të xhiros, për të cilën është bërë e mundur dalja e kuponit tatimor.

- Ndalon futjen e të dhënave të mëtejshme, në qoftë se të dhënat e futura nuk janë regjistruar njëkohësisht mbi shiritin e kuponit tatimor dhe QSHKE.

- Ndalon fshirjen e të dhënave nga memoria operative (RAM). Fshirja e të dhënave të memories operative lejohet vetëm duke hequr vulën fiskale nga tekniku i autorizuar sipas procedurave të miratuara me udhëzim nga Ministri i Financave dhe vetëm pasi të jetë kryer raporti tatimor ditor. Çdo fshirje e memories operative duhet të shoqërohet me regjistrimin e veprimit përmes rritjes së numrit të ndërhyrjeve teknike, e cila do të pasqyrohet në raportin tatimor ditor pasardhës. Tekniku i autorizuar rivendos vulën fiskale pas ndryshimeve të bëra dhe regjistron në librin e mirëmbajtjes procedurën e kryer.

- Ndalon ndryshimin e datës, orës së regjistrimit të xhiros dhe të të gjitha të dhënave të tjera, të regjistruara në memorien fiskale. Funksioni i ndryshimit të orës reale lejohet vetëm brenda kufirit të vetëm +/- një orë, pas kryerjes së raportit tatimor ditor.

- Ndalon fshirjen e xhiros ditore, përpara kryerjes së raportit tatimor ditor.

- Ndalon printimin e kuponit tatimor dhe të raporteve tatimore në regjimin e trajnimit.

- Ndalon fshirjen e numërorit, numrin e kuponëve tatimorë, numrin e ndryshimeve të shkallëve tatimore, numrin e fshirjes së memories operative (RAM), numrin e ndryshimeve të adresës.

- Për çdo riprintim të kuponit tatimor, raportet në regjimin e leximit të programimit dhe raportet e leximit të QSHKE-së janë jotatimore. Çdo raport në këto regjime duhet të kenë të printuar fjalët “INFO JOTATIMORE”.

-Përditësimi i programit logjik të pajisjes fiskale (Firmware) bëhet vetëm pasi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ketë lejuar në mënyrë shkresore një procedurë të tillë, si dhe duke hequr vulën fiskale duke hapur pajisjen fiskale. Kjo procedurë shoqërohet me regjistrimin e veprimit përmes rritjes së numrit të ndërhyrjeve teknike, e cila do të pasqyrohet në raportin tatimor ditor pasardhës. Tekniku i autorizuar rivendos vulën fiskale pas ndryshimeve të bëra dhe regjistron në librin e mirëmbajtjes procedurën e kryer.

- Ka një sensor, i cili automatikisht ndalon regjistrimin e mëtejshëm të xhiros në mungesë të letrës së kuponit tatimor.

- Ndalon automatikisht regjistrimin e mëtejshëm të xhiros në mungesë të letrës ose QSHKE-së.

- Mund t'i ofrojë klientit të mallrave dhe shërbimeve monitorimin vizual të të dhënave të regjistruara nga operatori.

- Si opcion shtesë, mund të lidhet me një program aplikativ të instaluar në një kompjuter, i cili duhet t'i transmetojë të dhënat në pajisjet fiskale, në kohë reale për çdo artikull. Regjistrimi i artikullit pasardhës, në programin aplikativ të kompjuterit, do të bëhet pas konfirmimit të marrë nga pajisja fiskale për regjistrimin e artikullit paraardhës. Skema e lidhjes në këtë rast do të miratohet nga komisioni i caktuar për verifikimin e pajisjeve dhe sistemeve fiskale i parashikuar në nenin 13.1 të kreut I "Dispozita të përgjithshme".

- Siguron që pajisja fiskale ose transmetuesi i të dhënave (modemi) GPRS, i cili është i identifikueshëm dhe funksional vetëm për atë pajisje fiskale, është i pajisur me një modul elektronik kodifikues (crypto-chip) që gjeneron dhe menaxhon dy çelësa (1 privat dhe 1 publik) RSA asimetrik për të nënshkruar në mënyrë elektronike të dhënat e transferuara në server.

- Është e pajisur me një dokument, që këtu e më poshtë do të referohet si pasaporta teknike e pajisjes, në të cilin janë të identifikuar me numër serial unik të gjitha pjesët përbërëse të pajisjes fiskale.

- Është e pajisur me një dokument që lëshohet nga një laborator ndërkombëtar i akreditur (i njohur nga sistemi ynë i akreditimit), i cili vërteton pas kryerjes së testit, të gjitha karakteristikat e përcaktuara më sipër dhe në përgjithësi në këtë vendim.

5.1 Memoria fiskale

Memoria fiskale ruan informacionin edhe në mungesë të furnizimit me energji elektrike (e tipit *nonvolatile*). Informacioni nuk mund të ndryshohet apo të fshihet, por vetëm të shkruhet dhe të lexohet. Memoria fiskale duhet të mbyllet si një modul, pjesë përbërëse e shasisë së pajisjes fiskale, duke e bërë pjesë të pandashme të saj. Memoria fiskale duhet të memorizojë të dhënat e regjistruara për një periudhë minimale kohore 5-vjeçare. Kapaciteti i memories fiskale duhet të sigurojë minimalisht ruajtjen e 1800 raporteve ditore fiskale.

- Memoria fiskale duhet të sigurojë jo më shumë se 20 ndryshime të shkallëve tatimore, 20 ndryshime të adresës dhe jo më shumë se 200 ndërhyrje për zhblokime të programit logjik (Firmware).

Memoria fiskale paralajmëron rreth numrit të raporteve fiskale të mbetura (jo më pak se 50) dhe tregon numrin e mundshëm të këtyre raporteve të mbetura pas çdo raporti fiskal të regjistruar.

Kur memoria fiskale është e mbushur (plot), pajisja fiskale nuk duhet të lejojë regjistrimin e mëtejshëm të xhiros. Zëvendësimi i memories fiskale do të bëhet nga shoqëria e autorizuar, vetëm pas autorizimit me shkrim të administratës tatimore dhe duke ndjekur procedurat e çregjistrimit dhe të regjistrimit të pajisjeve dhe sistemeve fiskale.

5.2 Qarku i shiritit të kontrollit elektronik (QSHKE)

Pajisja fiskale ka si qëllim të regjistrojë dhe të ruajë shitjet duke përdorur një mekanizëm për regjistrimin e qarkullimit i cili duhet të jetë i mbrojtur. Të dhënat duhet të regjistrohen në mënyrë të njëkohshme në një njësi memorieje si qarku i shiritit të kontrollit elektronik i cili vërtetëson dhe nuk lejon ndryshimet e informacionit.

5.2.1 QSHKE-ja është një memorie e zëvendësueshme e tipit "Flash", e cila kontrollohet nga programi logjik i pajisjes fiskale (Firmware) dhe duhet të sigurojë nivele të mjaftueshme të garancisë fiskale.

5.2.2 Qarku i shiritit të kontrollit elektronik është i realizuar sipas këtyre karakteristikave bazë:

a) Duhet të garantojë paprekshmërinë dhe të mos të lejojë ndryshimin e informacionit të regjistruar;

b) Në mungesë ose në rast defekti të QSHKE-së, pajisja fiskale duhet të bllokohet;

c) QSHKE-së duhet t'i kalohet një informacion i nevojshëm elektronik, i cili lejon të krijojë një lidhje logjike midis të dhënave të memorizuara dhe memories fiskale dhe të shërbejë si një mënyrë verifikimi e kësaj memorieje fiskale, ku totalët e vlerave të regjistruara janë të njëjta.

5.2.3 QSHKE-ja duhet të kontrollohet drejtpërdrejt nga programi logjik fiskal i pajisjes fiskale.

5.2.4 Programi logjik fiskal i pajisjes fiskale (Firmware) kontrollon QSHKE-në dhe duhet të realizojë këto funksione:

a) Inicializimin e QSHKE-së në mënyrë që të garantojë lidhjen logjike të përshkruar në pikën 5.2.2, paragrafi “c”;

b) Leximin e QSHKE-së dhe printimin e përmbajtjeve të plota të tyre, të paktën: për datë, midis dy datave, për numër kuponi, midis dy kuponëve. Mundësia e printimit duhet të jetë e lejuar edhe për QSHKE-në e përdorur më parë për atë pajisje fiskale.

c) Printimi i përmbajtjes së QSHKE-së duhet të kryhet sipas mënyrës së printimit të një kuponi administrimi jotatimor.

ç) Duhet të lajmërojë kur hapësira e memories së QSHKE-së është duke u mbushur.

d) Bllokimin e funksionimit të pajisjes fiskale në rast të mbushjes së QSHKE-së. Në këtë rast duhet të jetë i lejueshëm vetëm një veprim, kryerja e raportit tatimor ditor në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi dhe inicializimi i një QSHKE-je të re.

dh) Në rast të situatave anormale, si mungesa e QSHKE-së, heqja ose zëvendësimi me një QSHKE të një pajisjeje tjetër, ose kur QSHKE-ja është e re/papërdorur, apo kur të dhënat e regjistruara nuk përputhen menjëherë, duhet të kryhet sinjalizimi i operatorit i shoqëruar me bllokimin e funksionimit të pajisjes fiskale.

e) Printimin e listës së QSHKE-së të inicializuara për atë pajisje fiskale. QSHKE-të e mbushura duhet të ruhen për 5 vjet.

ë) Para se të regjistrohet raporti tatimor ditor në memorien fiskale, duhet të krahasojë totalin e regjistruar në memorien operative me shumën totale të regjistruar në QSHKE për atë periudhë. Nëse totalët përputhen, liron memorien operative dhe regjistron këto vlera në memorien fiskale ose bllokon pajisjen fiskale kur këto totale nuk janë të barabarta.

Ndalohet heqja dhe zëvendësimi i QSHKE-së me një të re nese kjo e fundit është e pambushur. Çdo QSHKE duhet të jetë e pajisur me një numër unik që pasqyrohet qartazi së bashku me kuponin e printuar nga regjistrimi themeltar, në pasaportën teknike të pajisjes fiskale dhe që e lidh me këtë të fundit.

5.3 Memoria operative

Memoria operative sipas pikës 5 të paragrafit 10 të këtij vendimi, ofron të dhënat për vlerat e mallrave të shitura dhe/ose të shërbimeve të paguara, të klasifikuara në ato, për të cilat është paguar TVSH-ja përkatëse dhe në ato të përjashtuara prej saj.

5.4 Programi logjik

Programi logjik i pajisjes fiskale (Firmware) është i ruajtur në një qark elektronik (EPROM) dhe lejon ndërveprimin me të gjitha pjesët përbërëse të këtyre pajisjeve. Lexon dhe shkruan në memorien fiskale, qarkun e shirit të kontrollit elektronik, përdor funksionet standarde për regjistrimin e shifrave të mallrave dhe shërbimeve, printimin, shfaqjen në ekran dhe administrimin e të dhënave të regjistruara në një memorie fiskale.

6. Sistemi fiskal për tatimpaguesit në sektorë të veçantë

6.1 Sistemi fiskal për shoqëritë e hidrokarbureve me pakicë

Sistemi fiskal që do të përdoret për shoqëritë e hidrokarbureve/shitësve me pakicë për regjistrimin e qarkullimit të shitjes, transferimit me pakicë të derivateve të naftës, duke regjistruar llojin, sasinë dhe vlerën, është një sistem fizik (Hardware), i përbërë nga dy elemente:

1. Pajisja fiskale sipas pikës 2 të këtij vendimi

2. Kontrolluesi i dispenserit elektronik (KDE)

Sistemi fiskal që do të zbatohet është dispenser-KDE-pajisje fiskale.

KDE-ja është pajisja që kontrollon e komandon qarkun elektronik të dispenserit dhe përpunon dhe transferon të dhënat e shitjes në pajisjen fiskale. Të gjitha dispenserat do të punojnë vetëm në regjimin automatik. Konstrukt i KDE-së është i ndërtuar sipas të njëjtave standarde si pajisja fiskale, me një pikë hapjeje, në të cilën do të vendoset vula fiskale, duke përfshirë edhe pikat e lidhjes së KDE-së.

KDE-ja ka një program logjik (Firmware) fiskal me këto karakteristika:

a) Në rast defekti të pajisjes fiskale apo lidhjes me të, KDE-ja duhet të memorizojë të dhënat e shitjes për 72 orë.

b) Në rast defekti të lidhjes me qarkun elektronik të dispenserit, KDE-ja duhet të memorizojë të dhënat e shitjes për gjithë periudhën që dispenserit është i shkëputur nga KDE-ja.

c) Në rast defekti të KDE-së, sistemi fiskal duhet të sigurojë mosfunksionimin e dispenserit deri në çastin e rregullimit të këtij defekti.

Nuk lejohet përdorimi i çfarëdolloj programi kompjuterik në transmetimin e të dhënave nga dispenserit në pajisjen fiskale.

Në portën e komunikimit të dispenserit lidhet vetëm KDE-ja.

Furnizimi me karburant kryhet vetëm pas autorizimit nga pajisja fiskale dhe KDE-ja sipas parimit “Pa kupon, s’ka karburant”.

KDE-ja lidhet në mënyrë aktive vetëm me pajisjen fiskale dhe bllokun dispenserin në rast shkëputjeje me pajisjen.

KDE-ja mund të ketë porta lidhëse pasive (jokomanduese) për kompjuter.

Të dhënat nga dispenserit mund të kalojnë në sistemin kompjuterik të tatimpaguesve vetëm pasi të jenë regjistruar në memorien fiskale. Skema e lidhjes në këtë rast do të miratohet nga komisioni i caktuar për verifikimin e sistemit fiskal i parashikuar në nenin 13.1 të kreut I “Dispozita të përgjithshme”.

Sistemi fiskal duhet të administrojë shitjet normale, shitjet me tollona, transferimet, testet për kalibrimet e pistoletave. Sistemi fiskal i administron këto mënyra sipas produktit, sasisë dhe vlerave. Këto informacione do të pasqyrohen të ndara sipas veprimit në raportin tatimor ditor dhe do të regjistrohen në memorien fiskale dhe QSHKE.

Sa kohë që garantohej siguria e lidhjes dhe komunikimit të informacionit nga dispenserit në pajisjen fiskale pa ndërhyrjen e programeve të tjera, komisioni i ngritur nga Ministri i Financave, sipas pikës 13/1 të këtij vendimi, mund të autorizojë përdorimin e një skeme tjetër lidhjeje nga ajo e përcaktuar më sipër.

6.2 Sistemi fiskal për shoqëritë e hidrokarbureve me shumicë

Sistemi fiskal që do të përdoret për shoqëritë e hidrokarbureve/shitësve me shumicë për regjistrimin e qarkullimit të shitjes me shumicë të derivateve të naftës, duke regjistruar llojin, sasinë dhe vlerën, është një sistem fizik (Hardware) i përbërë nga dy elemente:

a) Pajisja fiskale sipas pikës 2 të këtij vendimi;

b) Njësia matëse elektronike e litrave;

Njësia matëse e litrave vulozet sipas të njëjta kushteve dhe standarde të pajisjes fiskale.

Programi logjik (Firmware) i pajisjes fiskale që lidhet me njësinë matëse të litrave elektronikë përgatitet sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

7. Pajisjet shtesë

7.1 Një pajisje fiskale mund të ketë pajisje shtesë, si: lexues barkod-esh(skaner), terminal për pagesa me karta krediti/debiti, peshore dhe të tjera që mund të përcaktohen me udhëzimet përkatëse.

7.2 Pajisja fiskale me një terminal të integruar për pagesën me kartë krediti/debiti duhet të jetë në përputhje me standardet e kërkuara sipas udhëzimeve përkatëse.

8. Procedurat për pajisjen fiskale

8.1 Regjistrimi i të dhënave themeltare në memorien fiskale

8.1.1 Përpara se të fillojë hedhja e të dhënave të qarkullimit, nëpërmjet pajisjes fiskale në memorien fiskale, paraprakisht ato duhet të regjistrohen nga shoqëritë e autorizuar. Kjo procedurë kryhet me pajisje të hapur dhe vetëm në këtë rast moduli elektronik crypto-chip krijon 2 çelësat RSA asimetrik, çelësin privat e memorizon në chip-in e tij, me anë të të cilit do të gjenerojë firmën elektronike në raportet tatimore ditore dhe atë publik me anë të të cilit serveri qendror do të dekrptoje informacionin për të vërtetësuar firmën elektronike. Këtë çelës dhe bashkë me të dhënat që do të hidhen në këtë procedurë, pajisja fiskale e dërgon përmes rrjetit të komunikimit GPRS në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Të dhënat që do të regjistrohen dhe do të dërgohen janë si më poshtë vijon:

a) numri i identifikimit të tatimpaguesit;

b) emri, adresa ku është instaluar pajisja fiskale;

c) numri i identifikimit të pajisjes fiskale (ky numër është i përbërë nga dy shkronja për identifikimin e shoqërisë së autorizuar, 2 shifra për identifikimin e autorizimit për t'u hedhur në treg të pajisjes fiskale dhe 6 numra të tjerë);

ç) data, ora dhe minuta e fillimit të mbajtjes së regjistrimit të xhiros;

d) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);

dh) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);

e) çelësi RSA publik;

ë) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën e regjistrimit të pajisjes fiskale.

Pas dërgimit të të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me të dhënat si më sipër. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe bashkëngjijt kuponin e printuar në librin e mirëmbajtjes.

8.1.2 Nuk lejohet ndryshimi i të dhënave të pikës 8.1.1.

Nëse memoria fiskale pëson defekt, pajisja fiskale duhet të regjistrojë "Gabim" dhe të bllokohet.

8.2 Transferimi i pajisjes fiskale brenda të njëjtit subjekt

Transferimi do të bëhet pas miratimit me shkrim nga administrata tatimore dhe kjo procedurë kryhet nga tekniku i autorizuar. Ndryshimi i adresës është i mundur të bëhet vetëm pasi të jetë kryer raporti tatimor ditor me pajisje fiskale të hapura. Këto ndryshime do të pasqyrohen në rritjen e numrit të ndryshimeve të adresës, si dhe në raportin tatimor ditor pasardhës. Të dhënat e ndryshuara që do të dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit të komunikimit GPRS janë si më poshtë vijon:

a) numri i identifikimit të tatimpaguesit;

b) emri dhe adresa e re;

c) numri i identifikimit të pajisjes fiskale;

ç) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);

d) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);

dh) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën;

e) numërori i ndryshimit të adresës.

Pas dërgimit të këtyre të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me këto të dhëna. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe ia bashkëngjijt kuponin e printuar këtij libri.

8.3 Përfundimi i veprimtarisë së biznesit dhe çregjistrimi i pajisjes fiskale

8.3.1 Në rastin e përfundimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi është i detyruar të njoftojë administratën tatimore dhe shërbimin e mirëmbajtjes së shoqërisë së autorizuar, brenda tri ditëve nga dita e përfundimit të kësaj veprimtarie. Tekniku i autorizuar kryen procedurën e çregjistrimit me pajisje të hapur. Të gjitha të dhënat e memories fiskale që dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit GPRS janë si më poshtë vijon:

a) numri i identifikimit të tatimpaguesit;

b) emri, adresa ku është instaluar pajisja fiskale;

c) numri i identifikimit të pajisjes;

ç) data, ora dhe minuta e mbarimit të regjistrimit të xhiros;

d) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);

dh) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);

e) totalët e memories fiskale;

ë) totalët e shkallëve tatimore;

f) numërori i raporteve tatimore ditore;

g) numërori i kuponëve tatimore;

gj) numërori i ndërhyrjeve teknike;

h) numërori i ndryshimeve të shkallës tatimore;

i) numërori i ndryshimeve të adresës;

j) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën e çregjistrimit të pajisjes fiskale;

k) firma elektronike.

Pas dërgimit të të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me këto dhëna. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe ia bashkëngjit kuponin e printuar këtij libri.

8.3.2 Shoqëria e autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, kryen procedurën e çregjistrimit pasi administrata tatimore ta ketë miratuar, dhe ruan memorien fiskale, sipas pikës 8.3.1 të këtij vendimi.

8.3.3 Shoqëria e autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, ruan memorien fiskale, sipas pikave 8.3.1 dhe 8.3.2 të këtij vendimi, deri kur dega e tatimeve miraton, me shkrim, shkatërrimin e saj, në prani të një komisioni të përbërë nga punonjësit e shoqërisë së autorizuar të mirëmbajtjes dhe punonjësve të degës së tatimeve.

Dispozitat e paragrafëve të kësaj pike do të zbatohen edhe për ndryshimin e memories fiskale apo të pajisjes fiskale në rast defekti.

8.4 Kontrolli periodik

Tatimpaguesit janë të detyruar të kryejnë kontrollin teknik të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në jo më pak se çdo 6 muaj, në prani të stafit teknik të shoqërive të autorizuar. Shoqëritë e autorizuar janë të detyruara të plotësojnë dokumentacionin teknik bazuar në kontrollin teknik të kryer dhe ta dorëzojnë atë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

9. Procedurat e raportimit dhe të printimit

9.1 Raportimi periodik dhe afati

Pajisja fiskale dërgon në mënyrë automatike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të dhënat fiskale ditore mbas mbylljes së raportit tatimor ditor.

Në rastet kur transmetimi nuk realizohet, pajisja fiskale i ridërgon raportet tatimore ditore të patransmetuara në mbylljen e raportit tatimor ditor të ardhshëm.

Për transmetim të dhënash pas këtij afati aplikohen penalitetet e përcaktuara në nenin 113 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

9.1.1 Të dhënat e referuara në raportin e qarkullimit të mallrave e shërbimeve ruhen në memorien fiskale.

Raporti periodik përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e raporteve;
- b) emrin dhe adresën e tatimpaguesit;
- c) numrin e identifikimit të tatimpaguesit (NIPT-i);
- ç) numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;
- d) logon fiskale;
- dh) ditën, muajin, vitin, orën dhe minutën e përgatitjes së raportit;
- e) vlerën e qarkullimit total të mallrave dhe të shërbimeve;
- ë) vlerën e qarkullimit, sipas shkallës tatimore dhe/ose të përjashtimeve tatimore;
- f) shumën e tatimeve sipas shkallëve tatimore;
- g) numrin e kuponëve tatimorë, të emetuar të shiritit të pajisjes fiskale;
- gj) numrin e raportit të parë dhe të fundit në ditën e caktuar.

Në rastet e sistemeve fiskale sipas pikës 2.2, të dhënat e raportit periodik përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

9.2 Të dhënat e kuponit tatimor

9.2.1 Kuponi tatimor, që i jepet një blerësi apo një klienti, përmban këto të dhëna:

- a) emrin, adresën e tatimpaguesit dhe adresën e vendndodhjes së biznesit;
- b) NIPT-in;
- c) numrin e identifikimit të regjistruarit elektronik;
- ç) logon fiskale;
- d) numrin rendor të kuponit, datën dhe kohën;
- dh) emrin, sasinë, çmimin dhe vlerën e qarkullimit të regjistruar të mallrave dhe/ose të shërbimeve;
- e) shumën e TVSH-së, sipas shkallës tatimore;
- ë) vlerën e mallrave apo shërbimeve të shitura, të përjashtuara nga TVSH-ja;

f) mënyrën e pagesës (*cash*, çek, kartë krediti etj.).

Në rastet e sistemeve fiskale sipas pikës 2.2, të dhënat e kuponit tatimor përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

9.2.2 Kuponi tatimor mund të reklamohet edhe të dhëna të tjera të cilat duhet të ruhen edhe në QSHKE.

9.2.3 Përjashtohen nga detyrimi i lëshimit të kuponit tatimor:

a) tatimpaguesit, që paguajnë tatime mbi të ardhurat nga kryerja e veprimtarive për shuma të vogla të të ardhurave neto, me përjashtim të shoferëve të taksive;

b) personat, që nuk janë tregtarë dhe e realizojnë qarkullimin e produkteve bujqësore dhe të papërpunuara mbi tezgja, në tregjet e organizuara, si dhe jashtë merkatove;

c) individët, që lëshojnë me qira mjedise biznesi;

ç) veprimtaritë, të cilat ushtrohen në zona të larta malore, me popullim më pak se 300 individë dhe që janë të ndryshme nga vendet turistike.

9.3 Të dhënat e printuara

9.3.1 Të dhënat e printuara mbi kuponin tatimor duhet të jenë identike me të dhënat në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik (QSHKE).

9.3.2 Printimi i të dhënave mbi kuponin tatimor dhe shkrimi i tyre në shiritin e kontrollit elektronik duhet të jetë në të njëjtën kohë.

9.3.3 Tregimi i të dhënave mbi shiritin e kontrollit elektronik dhe në memorien fiskale nuk duhet të bëhet nëpërmjet përdorimit të shkurtimeve të kodifikuara.

9.4 Printimi i të dhënave

Printimi i të dhënave duhet të kryhet në shiritin (letër) e pajisjes elektronike fiskale e cila ruan të dhënat së paku për 5 vjet dhe që ka karakteristikat e përcaktuara në udhëzimet e Ministrit të Financave.

10. Gabimet

Gabimet (error) e ndodhura gjatë mbajtjes së regjistrimeve të qarkullimit (gjatë shtypjes, këmbimit të mallrave etj.), mund të eliminohen para nxjerrjes së kuponit tatimor. Eliminimi i defektit "Gabim" duhet të regjistrohet mbi kuponin tatimor, nëpërmjet anulimit të shënuar me "-".

11. Libri i raporteve dhe mirëmbajtjes

11.1 Tatimpaguesit mbajnë dhe ruajnë librin e raporteve ditore, i cili kontrollohet nga administrata tatimore. Raportet ditore futen në librin e raporteve ditore, i cili mbahet në ndërtesën, ku është edhe pajisja fiskale.

11.2 Format i dhe përmbajtja e librit të raportit ditor përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

11.3 Çdo pajisje fiskale duhet të jetë e pajisur nga shoqëria e autorizuar me një libër të posaçëm me numër faqesh të deklaruar dhe të numëruar në mënyrë progresive, në të cilën të paraqitet informacionet si më poshtë vijon:

a) Emri, adresa, NIPT-i i shoqërisë së autorizuar;

b) Të dhënat e certifikimit dhe të autorizimit për shitje të modelit të pajisjes fiskale;

c) Numri i identifikimit të pajisjes fiskale;

ç) Numri i faqeve të librit.

Në libër do të regjistrohet data, ora dhe vendi i instalimit dhe fiskalizimit të pajisjes fiskale, si dhe të regjistrohen të gjitha të dhënat e teknikut të autorizuar nga shoqëria e autorizuar, përfshirë vulën e identifikimit të tij. Në libër do të shënohen të gjitha ndërhyrjet e mirëmbajtjes teknike dhe të kontrollit teknik periodik.

12. Mosfunksionimi i përkohshëm i pajisjes fiskale

Në rastet e parregullsive apo të mirëmbajtjes së pajisjes fiskale, mbajtja e regjistrimeve të qarkullimit realizohet në mënyrën dhe formën e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave. Mosfunksionimi i përkohshëm i pajisjes fiskale duhet të pasqyrohet dhe të provohet në librin e mirëmbajtjes, ku tekniku i shoqërisë së autorizuar regjistron kohën, kur pajisja është riparuar.

13. Certifikimi i pajisjeve fiskale

13.1 Shoqëritë e autorizuar për furnizimin me pajisje apo sisteme fiskale janë të detyruara

të certifikojnë llojet që do të hedhin në treg, në laboratorë ndërkombëtarë/shqiptarë të certifikuar, njohur nga sistemi akreditues shqiptar.

Pajisjet dhe sistemet fiskale, përfshirë dhe skemën e lidhjes, para se të vihen në zbatim, miratohen nga komisioni i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave. Komisioni kryen verifikimin, kontrollin e dokumentacionit të certifikimit të tyre, të mënyrës së lidhjes dhe, në përgjithësi, përputhshmërinë e sistemit me kërkesat e këtij vendimi.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të paraqitur nga shoqëritë, komisioni merr vendim për autorizimin ose jo të shoqërive për t'i lejuar për tregtimin e këtyre pajisjeve.

Ky komision përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, AKSHI, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe, sipas rastit, nga përfaqësues të ministrive të linjës, apo të institucioneve të tjera, për të cilat gjykohet se kanë lidhje me veprimtarinë që do të kryhet.

13.2 Shoqëritë e autorizuar për furnizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve fiskale duhet të sigurojnë stafin teknik për mirëmbajtjen e tyre. Gjatë mirëmbajtjes, teknikët e shoqërive të autorizuar mbajnë procesverbal, në dy kopje, ku pasqyrohen të dhënat rreth tatimpaguesit, i cili ka pasur ankesa për parregullsi të pajisjeve fiskale. Procesverbalet i bashkëngjiten librit të mirëmbajtjes. Mirëmbajtja e pajisjes fiskale, përfshirë edhe mirëmbajtjen e memories fiskale, nuk duhet të zgjasë më shumë se dy ditë nga data e paraqitjes së ankesës për parregullsi.

13.3 Nëse vula e pajisjes fiskale duhet të hiqet gjatë procesit të mirëmbajtjes, vula e re pas mirëmbajtjes vendoset në praninë e përfaqësuesve të degës së tatimeve.

14. Ndërhyrjet e paautorizuara në pajisjen fiskale

Heqja e paautorizuar e vulave dhe/ose ndërhyrja në çdo lloj forme tjetër në një apo disa komponentë të pajisjes fiskale dhe/ose të pjesëve që janë pjesë e lidhjes dhe funksionimit të sistemit fiskal në përgjithësi, konsiderohet si ndryshimi apo ndërhyrje në aparatet dhe arkat matëse regjistruese e të lëshimit të kuponëve, dhe personat që kanë bërë apo lejuar të bëjnë këto ndryshime, përveç përgjegjësisë penale, detyrohen t'i shpërblejnë administratës tatimore dëmin e shkaktuar nga këto ndërhyrje.

Nëse stafi teknik i shoqërive të autorizuar për furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, gjatë kontrollit teknik vëren se tatimpaguesi ka kryer veprime për ndryshimin e të dhënave të qarkullimit të regjistruar, shoqëria e autorizuar është e detyruar të informojë menjëherë organin tatimor.

15. Procedura e instalimit të pajisjes fiskale

15.1 Tatimpaguesi aplikon për pajisje apo sistem fiskal pranë shoqërive të autorizuar.

Shoqëritë e autorizuar janë të detyruara të pajisin tatimpaguesin me sistem apo pajisje fiskale brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Shoqëritë e autorizuar kryejnë regjistrimin e të dhënave themeltare sipas pikës 8.1.2 të këtij vendimi.

Vulosja e pajisjes fiskale bëhet nga përfaqësuesi i shoqërisë së autorizuar, në prani të përfaqësuesve të degës së tatimeve.

Vula e pajisjes fiskale është unike dhe shënohet me një goditës (puncon) që ka të sigluar shenjat e vulës së identifikimit të teknikut të autorizuar.

15.2 Degët e tatimeve mbajnë regjistrime rreth pajisjes fiskale, nëpërmjet të cilave regjistrohet qarkullimi i tatimpaguesve. Format, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrimeve, sipas paragrafit të mësipërm, përcaktohen në këtë vendim. Mbajtja e regjistrimeve të xhiros, nëpërmjet pajisjes fiskale, nuk duhet të kryhet përpara vulosjes së pajisjes fiskale.

2. Në kreun II “Procedura e aplikimit dhe e autorizimit të shoqërive të autorizuar”, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) numërtimi nga 25 deri në 36 ndryshohet në renditjen 1 deri 12.

b) fjalët “...regjistruues elektronik...” zëvendësohet me fjalët “...pajisje fiskale...”.

3. Në kreun III “Dispozita tranzitore dhe të fundit” të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Numërtimi nga 37 deri në 38 ndryshohet në renditjen në 1 deri 2.

b) Pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Regjistrimet elektronike nëpërmjet pajisjeve fiskale ekzistuese mund të vazhdojnë të përdoren për regjistrimin e qarkullimit, vetëm me kushtin që karakteristikat e tyre teknike dhe funksionale, të jenë në përputhje të plotë me kërkesat e këtij vendimi.

Këto pajisje duhet të krijojnë një procedurë inicializimi pajisje fiskale-modem-SIM dhe informacioni që do të dërgohet do të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 8.1.1 të këtij vendimi me përjashtim të çelësit asimetrik publik. Këto pajisje mund të krijojnë firmën elektronike përmes një çelësi simetrik privat që pajisja fiskale e krijon në fazën e inicializimit pajisje fiskale-modem-SIM. Ky çelës transmetohet bashkë me informacionin sipas pikës 8.1.1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit të komunikimit GPRS. Algoritmi që do të përdoret për këtë qëllim do t’u komunikohet shoqërive nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve.

Përdoruesit e pajisjeve fiskale ekzistuese duhet të sigurojnë kontratë shërbimi mirëmbajtjeje me një shoqëri të autorizuar nga Ministria e Financave. Pajisjet dhe sistemet fiskale, përfshirë dhe skemën e lidhjes para se të vihen në zbatim miratohen nga komisioni i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave.”

c) Në pikën 2 , paragrafi pas shkronjës “ç” riformulohet si më poshtë vijon:

“ Nuk janë të detyruar të përdorin pajisje fiskale, sipas kërkesave të këtij vendimi, ambulantët dhe shërbimi i transportit, të përcaktuar në shtojcën nr.5 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

ç) Në pikën 2, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, tatimpaguesit me TVSH dhe që janë subjekt i biznesit të vogël”.

d) Në pikën 2, fjalët “...regjistruar elektronik...” zëvendësohen me fjalët “...pajisje fiskale...”.

e) Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Brenda një periudhe kohore 1-mujore shoqëritë e autorizuar janë të detyruara të verifikojnë procesin e certifikimit të pajisjeve, të sistemeve fiskale dhe të mënyrës së lidhjes të zbatuara të cilat nuk janë të pajisura me autorizimin e lëshuar nga komisioni i krijuar nga Ministri i Financave sipas pikës 13/1 të këtij vendimi.

4. Në rastet kur pajisjet, sistemet fiskale dhe lidhjet përkatëse nuk përmbushin kërkesat e shprehura nëpërmjet këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, Komisioni cakton një afat kohor prej 4 muajsh brenda të cilit shoqëritë e autorizuar duhet bëjnë zëvendësimin e pajisjeve fiskale, sistemeve fiskale apo lidhjeve përkatëse, me shpenzimet e tyre. Në rast se ato refuzojnë që me shpenzimet e tyre të zëvendësojnë brenda afatit të përcaktuar më sipër, pajisjet fiskale që nuk i plotësojnë karakteristikat e këtij vendimi, përfshi dhe skemën e lidhjes, Ministria e Financave rimbursin tatimpaguesin duke tërhequr garancinë që ka lënë shoqëria përkatëse e autorizuar. Përgjegjësia e Ministrisë së Financave për rimbursim, shtrihet deri në vlerën që shoqëria përkatëse ka lënë si garanci për zbatimin e kontratës nga ana e saj.

Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministria e Financave dhe shoqëritë e autorizuar, rishikojnë kontratat përkatëse me qëllim pasqyrimin e kushteve të këtij vendimi. Refuzimi për të arritur një marrëveshje mes palëve, përbën shkak për heqjen e autorizimit të shoqërisë së autorizuar.”

ë) Numërtimi nga 39 ndryshon në 5.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.100, datë 17.2.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.26, DATË 13.1.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2010, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.10190, datë 6.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.26, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2010, për ministrinë dhe institucionet qendrore është 89 129 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - b) Numri i punonjësve për Agjensinë Kombëtare Bërthamore është 8 veta.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare Bërthamore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Institucionet buxhetore	Numri i punonjësve organikë 2010
3	Kryeministria	128
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	785
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	2 163
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacionit	1 330
10	Ministria e Financave	3130
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	39 030
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1 089
13	Ministria e Shëndetësisë	3 444
14	Ministria e Drejtësisë	4 972
15	Aparati i Ministrisë së Punëve të Jashtme	187
	Përfaqësitë diplomatike	428
16	Ministria e Brendshme	13 382
17	Ministria e Mbrojtjes	11 735
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	940
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	29
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1 419
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1 360
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	24

78	Ministria e Integrimit	74
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare, nga të cilat:	149
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	37
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	8
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	35
	- Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit	15
	- Agjencia Kombëtare e Certifikimit Elektronik	10
	- Agjencia Kombëtare Bërthamore	8
	Total	86 219
	Total për institucionet e pavarura	2 910
	Total gjithsej	89 129

VENDIM
Nr.101, datë 17.2.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesa dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në fund të shkronjës “a” të pikës 1 të shtohen emërtesat “Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare” (QNOD) dhe “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit”.

b) Në shkronjën “b” të pikës 1 të bëhen ndryshime dhe shtesa e mëposhtme:

- Emërtesa “Instituti i Studimeve të Urbanistikës”, shfuqizohet.

- Shtohet emërtesa “Zyra e Shërbimit Turistik”.

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Zyrës së Shërbimit Turistik të përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e planifikuara për këto institucione për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve dhe punonjësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.102, datë 17.2.2010

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES, QË DO TË
TJETËRSOHET, NË FAVOR TË SUBJEKTIT KËRKUES “CITY PARK” SHPK, PËR
LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme me nr.696, zona kadastrale 1167, Bërxullë, Tiranë, me sipërfaqe 866 (tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², të regjistruar në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “City Park” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të përlllogaritet sipas vendimit nr.139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “City Park” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.103, datë 17.2.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 864, DATË 5. 12. 2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PËRCAKTIMIN E
KUSHTEVE, QË DUHET TË PLOTËSOJË STUDENTI, PËR MARRJEN E DIPLOMËS
PËR GRADËN SHKENCORE “DOKTOR”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5 të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”, shtohet pika 5/1, si më poshtë vijon:

“5/1. Promovimi i përshpejtuar i shkencëtarëve të rinj të talentuar të bëhet si më poshtë vijon:

a) Kandidatët, që kanë diplomë universitare të nivelit të dytë (DND) ose diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë (DIND) dhe kanë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë, në revista të huaja, me faktor impakti mbi 1.0, kanë të drejtë t'i paraqesin dekanit të fakultetit dhe, për dijeni, rektorit të institucionit të arsimit të lartë, që ofron studime të doktoratës, një kërkesë për mbrojtjen e doktoratës, mbi bazën e artikujve shkencorë të botuar (disertacion kumulativ). Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar nga dy referenca/rekomandime nga profesorë, të vendit ose të huaj, që vlerësojnë se vëllimi dhe cilësia e punimeve shkencore të përfunduara me botimet e sipërpërmendura, plotësojnë kushtet për kërkimin e gradës shkencore “Doktor” dhe i propozojnë këshillit të profesorëve e dekanit ngritjen e jurisë për provimin e doktoratës.

b) Dekani i fakultetit ia kalon kërkesën menjëherë këshillit të profesorëve, për shqyrtim, i cili shprehet, brenda një muaji nga marrja e kërkesës, për ngritjen e jurisë për provimin e doktoratës. Dekani nxjerr urdhër për ngritjen e saj.

c) Juria, brenda një muaji, vlerëson provimin e doktoratës së kandidatit, sipas vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar.

ç) Kandidatët, që nuk janë në marrëdhënie pune në një institucion të arsimit të lartë, i dërgojnë kërkesë dekanit të fakultetit të institucionit të arsimit të lartë, që zhvillon studime të doktoratës në fushën ku është kryer kërkimi shkencor dhe është përgatitur teza e disertacionit në formë kumulative.

d) Në rastet kur dekani dhe këshilli i profesorëve, të fakultetit, shprehen negativisht për kërkesën e kandidatit/es, ai/ajo ka të drejtë të ankohet te rektori i institucionit të arsimit të lartë dhe te Ministri i Arsimit dhe Shkencës, si dhe të kërkojë një rivlerësim të kërkesës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.91, datë 18.1.2010, shpall të vdekur shtetasin Redi Dhama, i datëlindjes 25.3.1974, lindur në Durrës, me datë vdekjeje 28.11.1998.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.129, datë 3.2.2010, shpall të vdekur shtetasen Zamira Sinjari, e datëlindjes 23.3.1986, lindur në Ura Vajgurore, me datë vdekjeje 8.8.2002.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.36, datë 20.1.2010, shpall të zhdukur shtetasin Petraq Kumati, i datëlindjes 20.5.1937, lindur Berat, dhe caktimin e shtetases Liliana Çuadarit, e bija e Petraqit dhe e Kates, e datëlindjes 30.6.1966, lindur dhe banuese në Kuçovë, si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKESË

Kërkuesi Demir Rustami, i biri i Mustafait dhe i Bejtjes, i datëlindjes 23.8.1928, lindur në Cermë, Bicak, Lushnjë dhe banues në fshatin Zhamë, Lushnjë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Halil Rustami, me datë zhdukjeje 31.12.1960.

KËRKUESI
Demir Rustami

KËRKESË

Kërkuesi Sokol Tabaku, i biri i Xhaferrit dhe i Xhevahires, i datëlindjes 3.4.1971, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Lulzim Tabaku.

KËRKUESI
Sokol Tabaku

KËRKESË

Kërkuesja Evgjeni Adhamidhi, e bija e Taqit dhe e Athinasë, e datëlindjes 1.4.1925, lindur në Berat dhe banuese në Fier, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier shpalljen të vdekur të shtetasve Qirjako Adhamidhi dhe Anastas Adhamidhi.

KËRKUESJA
Evgjeni Adhamidhi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 17.3.2010
Doli nga shtypi më 19.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë